

AKT THEMELIMI I SHOQËRISË
“GARDEN GOODIES” sh.p.k

Ne mbështetje të Ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 “*Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare*”, vendosa hartimin e këtij Akti Themelimi, me kushtet që përcaktohen si më poshtë:

Sot ne date 16.10.2023, ortaket e shoqerise:

z. KEVIN JAZAJ i datëlindjes 02.04.1994 shtetas Shqiptar, lindur në VLORE me ID J40402095A.

me vullnetin e tyre te lire dhe te plote, te shprehur nepermjet ketij akti themelimi, vendosi per krijimin e shoqerise tregtare "GARDEN GOODIES" Shpk me kushtet e meposhteme:

Neni 1
EMERTIMI

Shoqeria Tregtare do te ketë Emërtimin "GARDEN GOODIES" Shpk.

Neni 2
FORMA JURIDIKE

Shoqëria Tregtare "GARDEN GOODIES" Shpk, themelohet si Shoqëri Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar sh.p.k. Shoqëria është Person Juridik Privat Shqipëtar. Shoqëria krijohet në bazë të Ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, ku ne nenin 3 përcaktohet se:

” 1. Shoqëritë tregtare themelohen nga dy ose më shumë persona fizikë dhe/ose juridikë, që bien dakord për arritjen e objektivave ekonomikë të përbashkët, duke dhënë kontribute në shoqëri, sipas përcaktimeve në statutin e saj. Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë aksionare mund të themelohen edhe vetëm nga një person fizik dhe/ose juridik (shoqëritë me ortak apo aksionar të vetëm).

2. Shoqëritë tregtare duhet të regjistrohen sipas nenit 22 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, si dhe neneve në vijim, sipas formës përkatëse të shoqërisë tregtare.

3. Shoqëritë tregtare fitojnë personalitetin juridik në datën kur kryhet regjistrimi i tyre në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Shoqëritë përgjigjen me të gjitha aktivet e tyre për detyrimet, që rrjedhin nga veprimtaritë e ushtruara.”

Neni 3
KOHEZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë "GARDEN GOODIES" Sh.p.k do te vazhdoje veprimtarine e saj me një afat kohor te pakufizuar. *Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :*

a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;

b) me vendim të ortakeve te shoqerise;

c) me hapjen e procedurave të falimentimit;

ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;

d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaket e shoqerise marrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese “ Shoqeri ne likuidim e siper “.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket e shoqërisë.

Nëse Ortaket e shoqërisë nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 4

SELIA

Shoqëria Tregtare "GARDEN GOODIES" Sh.p.k e ka selinë në qytetin e Lagjia Kushtrimi, Rruga Miro Terbaci, Objekt Privat, Nr.20 Kati 1 ZK 8605, VLORE.

Shoqëria mund të ndryshojë seline e saj, të hapë zyrë përfaqësimi, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Ortakëve të Shoqërisë.

Neni 5

OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:

Import-Eksport, tregëtimin e artikujve të ndryshëm, etj.

Neni 6

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërisë është i përbërë nga kontributi i ortakëve themelues me vlerën **100,000 lekë** dhe përbehet nga 1 (një) kuote:

- **KEVIN JAZAJ** me kuote 100%

Neni 7

TRANSFERIMI I KUOTEVE

Kuotat e kapitalit janë lirisht të transferueshme ndërmjet Ortakëve. Ortaku që kërkon të shesë kuotën e tij një personi të tretë, duhet detyrimisht t'u njoftoj ortakëve të shoqërisë blerjen e kuotave të tij në të njëjtat kushte si personi i tretë të cilit ai dëshiron t'ia shesë. Kur disa ortakë ushtrojnë të drejtën e tyre të parblerjes dhe shprehin dëshirën e tyre për të blerë kuotën, ortakë shites gezon të drejtën diskrecionale për të zgjedhur se cilit ortak ai dëshiron t'i shesë totalisht ose pjesërisht kuotat e tij. Ortaket duhet të përgjigjen brenda 30 ditëve nëse dëshirojnë të blejnë kuotat e ofruara apo jo.

Neni 8

SHPERNDARJA E FITIMIT

Ortakët financojnë, përfitojnë rimbursim të financimit të tyre dhe ndajnë fitimin e tyre në bazë të kuotave në kapitalin themeltar.

Neni 9

ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE

Organet Drejtuese të Shoqërisë janë:

1. Administratori,
2. Asambleja e Përgjithshme e Zakonshme ose e Jashtëzakonshme e Ortakëve.

Aministrator i Shoqërisë është Z. • KEVIN JAZAJ i datëlindjes 02.04.1994, shtetas Shqiptar, lindur në VLORE me ID J40402095A.

Neni 10

KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

Administrator ushtron kompetenca ne emer te Shoqerise:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
 - b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
 - c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - d) përgatis dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
 - e) krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - f) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
 - g) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- Administratori është i detyruar të thërrasi mbledhjen e ortakut te vetem edhe ne rastet kur:
- a) sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe
 - b) kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,
 - c) Administratori ka të drejte të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakëve te shoqerise.
 - d) Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Neni 11

Veprimtaria ekonomike dhe financjare e shoqerise ndahet ne perjudha financiare 12 mujore. Viti financiare fillon nga data 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor te cdo viti kalendarik,me perjashtim te vitit te pare i cili fillon nga data e krijimit te shoqerise dhe mbaron me 31 Dhjetor.

Neni 12

Shoqeria mban dokumentacionin e nevojshem financiar per administrimin e pasurise dhe per zhvillimin e te gjithe veprimtarise se saj, ne perputhje me kerkesat e te gjithe legjislacionit perkates ne fuqi.

Bilanci financiar i shoqerise perpilohet ne baze te raportit me shkrim te eksperteve kontabel te autorizuar dhe te raportit te paraqitur nga administratoret brenda dates 31 mars te vitit pasardhes. Te dy raportet paraqiten me miratohen ne asamblene e ortakeve brenda dates 30 qershor.

Fitimi neto i shoqerise llogaritet mbasi zbriten humbjet e mundshme te vitit te meparshem,shlyerja e te gjitha detyrimeve fiskale dhe ndaj cdo personi te trete,si dhe fondet financiare qe perbejne rezerven e detyrueshem.

Neni 13

ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE

Mosmarrveshjet lidhur me themelimin dhe zhvillimin e veprimtarise se shoqerise zgjidhen nga vete ortakët e shoqerise me mirekuptim, dhe kur kjo nuk arrihet ato zgjidhen nga gjykata ne territorin e se ciles ndodhet selia e shoqerise.

Neni 14

Ky Akt Themelimi u hartua në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën Shqipe.

ORTAKET E SHOQËRISË “GARDEN GOODIES” Sh.P.K
KEVIN JAZAJ